**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

# RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| Eksperti Shqyrtues | Data e autorizimit të ekspertit | Date e dorëzimit të raportit | Nr. i lëndës |
|---|---|---|---|
| **Majlinda Bedrolli** | **09.12.2025** | **24.12.2025** | **2025/1191** |
| Eksperti Teknik<br>**Kreshnik Spahiu** | Data e autorizimit të ekspertit teknik<br>**11.12.2025** | | |

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 04.12.2025, OE "ARITECH"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/1191, kundër njoftimit për kontratë kritereve, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Blerja, furnizimi, montimi dhe instalimi i tabelave te mençura (smartboard) per qellime arsimore per institucionet e arsimit parauniversitar" me nr. të prokurimit: "208 Udheheqesi-25-3443-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E ARSIMIT.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur,lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 8,500,000.00 €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më **Nr. 2025/416 i dt:16.07.2025 dhe Vendimi Nr. 2025/741 i dt:09.10.2025.** Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

AK gjatë realizimit të kësaj procedure ka shkelur dispozitat e LPP-së si më poshtë:

**Neni 1 – Qëllimi dhe Parimet Themelore të Prokurimit**

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për

3/10

vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

**Neni 7**
**Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

**Neni 27**
**Dosja e Tenderit**

**4.** Kurdo që një aktivitet i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, dosja e tenderit duhet të kompletohet para publikimit të njoftimit të kontratës; KRPP-ja mund të vendosë për monitorimin e kësaj dispozite, me akte nënligjore. Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike.

**Neni 28**
**Specifikimet teknike**

2. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

**Neni 69**
**Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale**

1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkese, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen.

2. Gjatë udhëheqjes së procedurave që shpien drejt dhënies së kontratës publike në të cilën përfshihet livrimin i produkteve, nga operatorët ekonomik mund të kërkohet që të dëshmojnë aftësinë e tyre teknike përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë

2.4 mostrave të produktit, përshkrimeve, prezantimeve grafike dhe/ose fotografive të produkteve që duhet të furnizohen; dhe/ose

**8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

Ne, si Operator Ekonomik i interesuar për pjesëmarrje në aktivitetin e prokurimit për furnizim me Smartborde, shpallur me **02.05.2025**, me vlerë të parashikuar 8.5 milionë euro, paraqesim këtë **Ankesë në OSHP**, në lidhje me vendimin e datës **24.11.2025**, përmes së cilit:

- është shtuar **kërkesa obligative për dorëzim të MOSTRËS**, dhe
- është shtyrë afati i ofertimit deri më **04.12.2025**.

Ne vlerësojmë se ky ndryshim:

- është i vonshëm,
- është i pajustifikuar teknikisht,
- është joproporcional,
- dhe ka efekt të qartë **përjashtues** ndaj operatorëve.

Gjatë gjithë këtij procesi, janë vërejtur parregullsi edhe të konfirmuara nga OSHP, të cilat e bëjnë këtë kërkesë të fundit edhe më problematike dhe në kundërshtim me LPP.

PARREGULLSITË E KONFIRMUARA NGA OSHP

1. Ankesa e OE Cacttus Sh.A – 28.05.2025
OSHP, me vendimin nr. 2025/0416, datë 16.07.2025, konstatoi se:
"Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit."

Problemet e evidentuara:

- specifikime të hartuara në mënyrë të favorshme për një prodhues të vetëm (SAMSUNG),
- kërkesa teknike të panevojshme,
- kufizim i konkurrencës.

Ankesa e OE Solution Shpk – 04.08.2025
OSHP, me vendimin nr. 2025/0741, datë 09.10.2025, konstatoi:
"Ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar."

PARREGULLSITË E VAZHDUESHME TË AK-së

5/10

Në proces janë vërejtur një sërë kërkesash të pajustifikuara:

- ISO të parëndësishme për natyrën e projektit;
- specifikim teknik i ndërtuar për një prodhues të vetëm;
- kërkesa akademike (Master/Bachelor) pa asnjë lidhje me punimet e montimit fizik.

Shtimi i kërkesës për **mostër** është vazhdimësi e këtij modeli diskriminues.

KUNDËRSHTIM I KËRKESËS PËR MOSTËR

1. Neni 69.2.4 I LPP-së lejon kërkimin e mostrës vetëm nëse është "relevante dhe e nevojshme"

Ligji thotë qartë:

"Mostrat e produktit mund të kërkohen vetëm nëse është relevante dhe e nevojshme."
Kërkesa për Moster në këtë faze e jo prej fillimit e bën edhe më tendencioze!

Në këtë rast:
**Mostra nuk është relevante,**
sepse pajisja vlerësohet përmes dokumentacionit teknik (specifikimet teknike, testime etj).

**Mostra nuk është e nevojshme,**
sepse AK ka vlerësuar pajisje të ngjashme në projekte të mëparshme pa kërkuar mostër.
Pra, kërkesa është **në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 69**.

Teknikisht është e PAMUNDUR për operatorët të sigurojnë mostër brenda 6 ditëve pune

Pajisjet e specifikuara:

- **prodhohen vetëm me porosi**,
- nuk janë produkte stoku,
- kanë **afat prodhimi që tejkalon 6 ditë**,
- transporti tokë/det nga Lindja e Largët kërkon **45–60 ditë**,
- transporti ajror për produkte me bateri kërkon minimumi 14 ditë, pa përfshirë doganimin.

Pra:
Kërkesa është teknikisht e pamundur për t'u realizuar.
Ky fakt e bën atë diskriminuese, sipas nenit 7.

Kërkesa është JOPROPORCIONALE – Shkelje e Nenit 7 (Mosdiskriminim & Barazi)

Neni 7 kërkon proporcionalitet.
Por kërkesa për dorëzim të një pajisjeje me vlerë të lartë:

- rrit kostot në mënyrë ekstreme,
- përjashton operatorët që porosisin nga jashtë,
- favorizon operatorin që e ka sjellë pajisjen paraprakisht,
- cenon barazinë e pjesëmarrësve.

Kjo është natyra e qartë e një **kriteri të panevojshëm përjashtues**.

6/10

**AK nuk e ka kërkuar këtë për pajisje më të avancuara teknologjikisht në tenderë të mëparshëm**

MASHT/AK ka blerë:

- serverë,
- laptopë,
- projektorë,
- smartborde të modeleve të tjera,
- pajisje me kompleksitet të lartë,

**pa kërkuar ndonjëherë mostër**.

Kjo e bën vendimin aktual të pajustifikuar dhe të pashpjegueshëm.

**Dyshimet tona, duke u bazuar që ky projekt ka qene pjesë Ankimimeve disa here në OSHP, tregon qe kërkesa favorizon një operator të vetëm:**

- vetëm një operator ka pasur mundësi të sjellë paraprakisht produktin në Kosovë,
- ndërsa të gjithë operatorët e tjerë penalizohen me përjashtim,
- duke mos pasur njohuri për këtë kërkesë deri më 24.11.2025.

Kjo sugjeron qartazi se:

**OE i parapërzgjedhur ka qenë i informuar me kohë.**
**Konkurrenca është cenuar rëndë.**

Mostra, nëse kërkohet, kërkohet vetëm në fazën post-kualifikuese

Nëse AK ka nevojë për mostër (gjë që këtu nuk ekziston):

- duhet kërkuar **vetëm nga OE që renditet i pari** në vlerësim teknik + ekonomik,
- JO nga të gjithë operatorët,
- JO në fazën e ofertimit,
- dhe JO brenda një afati të pamundur.

**KËRKESAT TONA DREJTUAR OSHP-së**

Bazuar në argumentet ligjore, teknike dhe procedurale të evidentuara, kërkojmë nga OSHP-ja që të marrë këto masa:

1. Të anulojë kërkesën e Autoritetit Kontraktues për dorëzimin e MOSTRAVE, të shtuar më datë 24.11.2025, pasi paraqet ndryshim substancial të kushteve të tenderit dhe është vendosur jashtë çdo baze ligjore.
2. Të pezullojë aktivitetin e prokurimit, me qëllim evitimin e deformimit të konkurrencës dhe krijimit të kushteve të pabarabarta ndërmjet operatorëve ekonomikë.
3. Të urdhërojë rikthimin e kushteve origjinale të Dosjes së Tenderit, duke hequr çdo kriter të shtuar artificialisht dhe në kundërshtim me LPP-në.
4. Të garantojë respektimin e parimeve të barazisë, transparencës dhe konkurrencës së drejtë, të cilat janë thelbësore në procedurat e prokurimit publik.

**1. Referenca e pasaktë për zgjatjen e afatit**

Në dokumentacionin e AK-së, ndër të tjera, është theksuar se:

- “Afati është zgjatur për 10 ditë pune, sipas kërkesës ligjore minimale.”

Kjo referencë është faktikisht e pasaktë, sepse afati nuk është zgjatur për 10 ditë pune, por për 10 ditë kalendarike, Përkatesisht 7 dite pune, Si e tillë:

- pretendimi i AK-se që zgjatja është bërë për 10 dite pune është i pasakt.
- dhe përdorimi i kësaj reference paraqitet si tentativë për të krijuar përshtypjen e një zgjatjeje të mjaftueshme të afatit, gjë që në realitet nuk ka ndodhur.

Kjo tregon se edhe vetë AK-ja është e vetëdijshme për ndikimin që korrigjimet dhe kërkesat e reja (si mostra) kanë në proces, por zgjatja reale e afatit nuk e adreson këtë ndikim në mënyrë proporcionale dhe të drejtë.

**2. Numri i madh i kërkesave për rishqyrtim nga operatorët ekonomikë**

Sipas të dhënave tona:

- për këtë aktivitet prokurimi ekzistojnë disa kërkesa për rishqyrtim nga së paku 4 operatorë ekonomikë, të cilët kanë kundërshtuar qartazi këtë qasje të AK-së,
- **vetëm në muajin nëntor** janë paraqitur **8 kërkesa për Rishqyrtim** nga operatorë të ndryshëm,
- pa llogaritur edhe 9 kërkesa të tjera paraprake që lidhen po me këtë aktivitet të prokurimit.

Ky volum i madh i reagimeve tregon se pakënaqësia nuk është e izoluar, por përfaqëson një qëndrim të gjerë të operatorëve ekonomikë ndaj mënyrës si po menaxhohet ky aktivitet. Në këtë kontekst, pretendimet e AK-së se gjoja ekziston “interesim për prolongim të procesit” nga ana e operatorëve janë jo serioze dhe të pabazuara:

- Po të ishte vërtet kërkesë për prolongim, nuk do të shoqërohej me kaq shumë ankesa formale dhe kundërshtime me shkrim.
- Faktikisht, ajo që operatorët ekonomikë kanë kërkuar që nga fillimi është mosvendosja e kërkesave përjashtuese dhe krijimi i kushteve për pjesëmarrje sa më të gjerë, e jo shtyrje artificiale të procesit.

3. Kërkesa për mostra – teknike, juridike dhe procedurale e papranueshme

**Kërkesa e vonshme për dorëzimin e mostrave**:

- është teknikisht e papërmbushshme brenda afatit të dhënë,
- është juridikisht e pambështetur, pasi ndryshimet substanciale të DT-së pas publikimit të njoftimit për kontratë bien ndesh me LPP-në,
- është në kundërshtim me:
    - parimin e trajtimeve të barabarta,
    - parimin e proporcionalitetit,
    - dhe parimin e transparencës në prokurim.

Si e tillë, kjo kërkesë krijon kushtet për deformim të konkurrencës dhe ushqen dyshimin e arsyeshëm se po bëhet parapërgatitje për të neutralizuar pjesëmarrjen sa më të gjerë dhe për të favorizuar një ose disa operatorë të caktuar.

8/10

**PASOJAT DHE INTERESI PUBLIK**

Zvarritjet, korrigjimet e përsëritura dhe vendosja e kritereve të reja, në vend që të sqarojnë procesin, po e bëjnë atë më të paqartë dhe më pak konkurrues, duke:

- rrezikuar vonesat e panevojshme në përfundimin e aktivitetit,
- dëmtuar interesin publik,
- dhe vonuar përfitimet për përfituesit finalë – nxënësit e Republikës së Kosovës.

**KËRKESAT PËRFUNDIMTARE DREJTUAR OSHP-së**

Duke u mbështetur në sa më sipër, kërkojmë nga OSHP-ja që:

1. Të konstatojë se kërkesa për mostra, e shtuar më 24.11.2025, është në kundërshtim me LPP-në dhe duhet anuluar.
2. Të konstatojë se zgjatja e afatit nuk është bërë sipas kërkesës ligjore minimale siç i është referuar prej 10 ditësh pune, por vetëm 10 ditë kalendarike, dhe si e tillë është e pamjaftueshme.
3. Të marrë vendim për pezullimin e aktivitetit të prokurimit deri në rregullimin e plotë të shkeljeve të konstatuara.
4. Të urdhërojë rikthimin e kushteve origjinale të Dosjes së Tenderit, pa kritere të shtuara artificialisht dhe pa kërkesa përjashtuese.
5. Të garantojë se procedura do të zhvillohet në përputhje me parimet e konkurrencës së drejtë, transparencës dhe trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

**PËRFUNDIM**

Kjo ankesë paraqitet brenda afatit ligjor dhe me qëllim:

- të mbrohet konkurrenca reale,
- të parandalohet deformimi i tregut,
- dhe të sigurohet një proces i drejtë dhe i paanshëm prokurimi.

KRITERET PËR VLERËSIM

| | | |
|---|---|---|
| **AFATIN E DORZIMIT TË OFERTAVE** | **27.11.2025 13:00:00** | **04.12.2025 13:00:00** |
| | | |
| | | |
| **Kërkesat e përshtatshmërisë** | | **a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit me Informata mbi biznesin dhe veprimtaritë. b. Deklarues i TVSH-së, (për kompanitë vendore)., a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit, me informata dhe veprimtaritë e biznesit (kopje). b. Certifikata e TVSH-së (kopje).** |
| **Kapaciteti ekonomik dhe financiar** | | **Kapaciteti ekonomik dhe financiar 1. Operatori ekonomik duhet ti ofroje dëshmi te kënaqshme Autoritetit kontraktues, se qarkullimi vjetor (të hyrat) e OE gjatë tri viteve për Lot I duhet ti ketë 5,000,000.00 €. Lot II duhet ti ketë 5,000,000.00 €., Dëshmia e kërkuar dokumentare 1. Kopjet e Deklaratave Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore apo Pasqyrat e Audituara Financiare dhe Vertetimin e Qarkullimit Bankar nga vendi i origjinës.** |
| **Kapaciteti teknik dhe profesional** | | **Kapaciteti teknik dhe professional 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në vlerë për Lot I duhet ti ketë 4,000,000.00 €. Lot II duhet ti ketë 4,000,000.00 €., Dëshmia e kërkuar dokumentare Dëshmi 1. Lista e kontratave, projekteve me të cilën saktësohen shërbimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Listës** |

| | |
|---|---|
| | duhet ti bashkëngjiten dëshmi kopjen e certifikatës (certifikatave) ose referencës, të nënshkruara nga pranuesi i shërbimeve për kontratat dhe projektet e cekura në listë, (kopje). |
| Kapaciteti teknik dhe profesional | 1. Operatori ekonomik duhet të kenë autorizim nga prodhuesi (MAF) apo distributori (DAF) për produktet e ofruara 2. Operatori ekonomik duhet të ketë Deklaratë për garancionin e produkteve 3. Operatori ekonomik duhet të ofrojë katalogët broshura me standard të BE-së (CE), 1. Autorizimi nga Prodhuesi (MAF) apo distributori (DAF) në emër të operatorit ekonomik 2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar dhe vulosur nga OE dhe nga prodhuesi i produktit apo distributori i autorizuar, në të cilën vërtetohet se pajisja e ofertuar është produkt me shenjë CE dhe përputhet me direktivat dhe standardet relevante të Bashkimit Evropian. Deklarata duhet të shoqërohet me EU (Deklarata e Konformitetit) e lëshuar nga prodhuesi për modelin përkatës të produktit.”,nese ofrohet autorizimi nga Distributori, duhet qe distributori të jete i autorizuar nga prodhuesi për te mbuluar (ofruar sherbime dhe produkte)) ne territorin e Kosoves 3. Katalogu i produkteve dhe mundësia e verifikimit zyrtar |
| Kapaciteti teknik dhe profesional | 1. Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet te ketë Stafin profesional 1. Një (1) Menaxher të Projektit, i cili duhet të ketë a. Të përfunduara studimet Universitare në Master i Shkencave ose Inxhinierisë Kompjuterike; b. Përvojë pune se paku 3 vjeçare pas |

| | |
|---|---|
| | diplomimit në projekte të ngjajshme, 1. Lista e stafit origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga OE 2. Për menaxher të projektit a. Diplomë Universitare përkatëse. b. Kontratë ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje); c. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(Kopje); d. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër duke specifikuar titullin e projektit që dëshmon përvojën në projektet e realizuara –(Kopje) f. CV-në. g. Vendimin për menaxher të projektit (original). |
| Kapaciteti teknik dhe profesional | 2. Një (1) Ekspert të teknologjisë së informacionit cili duhet të ketë a. të përfunduara studimet Universitare në Master i Shkencave ose Inxhinierisë Kompjuterike, b. Të ketë përvojë pune se paku 3 vite pas diplomimit. 3. Dy (2) Ekspert të Pajisjeve të TI-së të cilët duhet të kenë a. Të përfunduara studimet Universitare Baçelor i Inxhinierisë Kompjuterike ose Baçelor i Shkencave Kompjuterike, b. Të ketë përvojë pune se paku 3 vjeçare pas diplomimi 4. Një (1) Analist të Projektit, i cili duhet të kenë a. Të përfunduara studimet Universitare Baçelor i Inxhinierisë Kompjuterike ose Baçelor i Shkencave Kompjuterike, b. Të ketë përvojë pune se paku 1 vjeçare pas diplomimi., 2. Për Ekspert të teknologjisë së informacionit a. Diplomë Universitare përkatëse e kërkuar. b. Kontratë ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt |

| | |
|---|---|
| | (kopje); c. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(Kopje); d. CV-në 3 Për Ekspert të Pajisjeve të TI-së a. Diplomë Universitare përkatëse e kërkuar. b. Kontratë ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje); c. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(Kopje); d. CV-në 4. Për Një (1) Analist të projektit a. Diplomë Universitare përkatëse e kërkuar. b. Kontratë ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje); c. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(Kopje); d. CV-në |
| Kapaciteti teknik dhe profesional | 1. OE duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001 2015., 1. Certifikatë ISO 9001 2015 (original),Ne rast konzorciumi vetem njeri nga antaret e konzorciumit |
| | |
| | |

-------------------------------------- *(Shto nenin IV.2.3 sa here qe keni nevoje)* ------------------------------

**Blerja, furnizimi, montimi dhe instalimi i tabelave te mencura (smartboard)**

| | Specifikat teknike LLOT I për Prishtinë,Mitrovicë,Pejë | Njesia | Sasia | Çmimi njesi me TVSH | Çmimi total me TVSH |
|---|---|---|---|---|---|
| Display | Touchscreen, Infrared (InGlass Touch), Multi-Touch, 75" (190.5cm), 3840x2160 (4K UHD), 16:9, 59ppi, 60Hz (3840x2160), Response time 6ms, LED, brightness 350cd/m², contrast 4.000:1, angle view 178°/178° | | | | |
| Touch | Multi-Annotation up to 4 | | | | |
| | Passive Pen with Magnet | | | | |
| | 2mm / 4mm / 8mm / 50mm | | | | |
| | (Brush Mode: Dynamic Object Recognition) | | | | |
| | Touch speed 6.7ms, Drawing time 26ms, AG Film (Anti glare), | | | | |
| | Ekrani duhet te jetë hidrofobik (rezistent ndaj lagështisë dhe ujit), rezistent ndaj goditjeve dhe gërvishtjeve, dhe antimikrobial. | | | | |
| Connectivity | HDMI 2 (Rear 1, Front 1), | | | | |
| | DP 1, USB C (Front), OPS I/F | | | | |
| | 2 (For SoC, Rear / Front), | | | | |
| | 1 (for external 3.0x1 (Front)) | | | | |
| | 1 (Stereo Mini Jack) | | | | |
| | Touch Out 2 (USB Upstream Type, Front 1, Rear 1) | | | | |
| | Touch Input, RS232C thru Stereo Jack, RJ45 (For MDC) | | | | |
| | Yes (Keyboard / Mouse, Speaker) | | | | |
| | Built in Speaker (4x10W), WiFi / BT Module, Document Viewer, Video Player, Web Browser, Workspace, (RDP /VNC, Office365, VMWare) | copë | 1873 | | |
| **Feature** (Karakteristikat në këtë pjesë janë kërkesa minimale dhe mund të ekuivalentohen me karakteristika të ngjashme) | Pajisja duhet te ketë te instaluar aplikacion(e) e prodhuesit qe mundëson shkrimin/vizatimin dhe bashkëpunimin ne kohe reale përmes touch screen, si dhe te lejoje integrimin e lehte me pajisje te treta si latptop, tablet, telefon dhe te ngjashme. | | | | |
| | Smartboard duhet te ketë softuer te integruar nga prodhuesi ne ekranet interaktive qe mundësojnë funksione si shkrimi dhe bashkëpunimi si dhe ndarjen e ekranit te smartboard me 4 pajisje njëkohësisht | | | | |
| | Pajisja duhet te ketë sistem operativ qe mundëson ndërfaqen mes përdoruesit dhe pajisjes, përmes touch screen, me ndarje te ekranit dhe qe mbështet deri ne 4 pajisje njëkohësisht. | | | | |
| | Procesori: Minimum 1.7 GHz, Quad-Core, 32 bit, 2MB cache) | | | | |
| | Memoria e brendshme: 32 GB | | | | |
| **Speaker** | 4x10W | | | | |
| **Weight** | 60 ± 20% kg NETO | | | | |
| **Warranty** | 3 years | | | | |
| **Totali me të gjitha taksat** | | | | | |

**Blerja, furnizimi, montimi dhe instalimi i tabelave te mencura (smartboard)**

| | **Specifikat teknike LLOT II Prizren,Ferizaj,Gjilan dhe Gjakovë** | | Sasia | Çmimi njesi me TVSH | Çmimi total me TVSH |
|---|---|---|---|---|---|
| **Display** | Touchscreen, Infrared (InGlass Touch), Multi-Touch, 75" (190.5cm), 3840x2160 (4K UHD), 16:9, 59ppi, 60Hz (3840x2160), Response time 6ms, LED, brightness 350cd/m², contrast 4.000:1, angle view 178°/178° | | | | |
| **Touch** | Multi-Annotation up to 4 | | | | |
| | Passive Pen with Magnet | | | | |
| | 2mm / 4mm / 8mm / 50mm | | | | |
| | (Brush Mode: Dynamic Object Recognition) | | | | |
| | Touch speed 6.7ms, Drawing time 26ms, AG Film (Anti glare), | | | | |
| | Ekrani duhet te jetë hidrofobik (rezistent ndaj lagështisë dhe ujit), rezistent ndaj goditjeve dhe gërvishtjeve, dhe antimikrobial. | | | | |
| **Connectivity** | HDMI 2 (Rear 1, Front 1), | | | | |
| | DP 1, USB C (Front), OPS I/F | | | | |
| | 2 (For SoC, Rear / Front), | | | | |
| | 1 (for external 3.0x1 (Front)) | | | | |
| | 1 (Stereo Mini Jack) | | | | |
| | Touch Out 2 (USB Upstream Type, Front 1, Rear 1) | | | | |
| | Touch Input, RS232C thru Stereo Jack, RJ45 (For MDC) | | | | |
| | Yes (Keyboard / Mouse, Speaker) | | | | |
| **Feature** (Karakteristikat në këtë pjesë janë kërkesa minimale dhe mund të ekuivalentohen me karakteristika të ngjashme) | Built in Speaker (4x10W), WiFi / BT Module, Document Viewer, Video Player, Web Browser, Workspace, (RDP /VNC, Office365, VMWare) | copë | 2049 | | |
| | Pajisja duhet te ketë te instaluar aplikacion(e) e prodhuesit qe mundëson shkrimin/vizatimin dhe bashkëpunimin ne kohe reale përmes touch screen, si dhe te lejoje integrimin e lehte me pajisje te treta si latptop, tablet, telefon dhe te ngjashme. | | | | |
| | Smartboard duhet te ketë softuer te integruar nga prodhuesi ne ekranet interaktive qe mundësojnë funksione si shkrimi dhe bashkëpunimi si dhe ndarjen e ekranit te smartboard me 4 pajisje njëkohësisht | | | | |
| | Pajisja duhet te ketë sistem operativ qe mundëson ndërfaqen mes përdoruesit dhe pajisjes, përmes touch screen, me ndarje te ekranit dhe qe mbështet deri ne 4 pajisje njëkohësisht. | | | | |
| | Procesori: Minimum 1.7 GHz, Quad-Core, 32 bit, 2MB cache) | | | | |
| | Memoria e brendshme: 32 GB | | | | |
| **Speaker** | 4x10W | | | | |
| **Weight** | 60 ± 20% kg NETO | | | | |
| **Warranty** | 3 years | | | | |
| **Totali me të gjitha taksat** | | | | | |

## RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

## INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

## VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

## VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimet e mëparshëm të OSHP - së,

**Vendimi Nr. 2025/416 i dt:16.07.2025**

**Vendimi Nr. 2025/741 i dt:09.10.2025.**

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

## PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **ARITECH**

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Arsimit, për këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim. Vlera e parashikuar e kontratës është 8,500,000.00€ .Ndërsa, kriter i dhënies së kontratës është Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët.

Sqarim hyrës: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 27, 28, dhe 69 të LPP-së. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për kontratë (kritereve), kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP dy herë, ndërsa **eksperti shqyrtues/teknik** kanë nxjerr raport të ekspertizës me Nr.0416/2025, të datës 17.06.2025, dhe raport të ekspertizës me Nr.0741/2025, të datës 25.08.2025

Po ashtu, Paneli Shqyrtues ka gjykuar me **Vendimin PSH.nr.0416/2025**, të datës 16.07.2025, dhe **Vendimin PSH.nr.0741/2025**, të datës 09.10.2025. Ankesa e OE ankues, më saktë pretendimet ankimore janë shqyrtuar nga eksperti shqyrtues/teknik duke u bazuar në shkresat e lëndës, ndërsa

përgjigjen si në vijim.

Parashtruesi i ankesës, Aritech Sh.P.K. (OE ankues) me datë: 27.11.2025 ka dorëzuar kërkesë për rishqyrtim me kërkesa dhe pretendime ankimore te qarta dhe të argumentuara, për të cilat AK me datë 03.12.2025 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim. Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, janë paraqitur dy ankesa, për të cilat Panelit Shqyrtues i OSHP-së, ka vendosur sipas vendimit 2025/0416 dhe 2025/0741. Gjithashtu, në këtë fazë është paraqitue edhe ankesa me numër 2025/1194.

Pretendimet ankimore i OE ankues

OE ankues kundërshton vendimin e AK-së për ndryshimin e datës 24.11.2025, me të cilin është shtuar kërkesa për dorëzim të mostrës dhe është zgjatur afati i ofertimit. Sipas OE ankues ndryshimi është i vonshëm, i pajustifikuar teknikisht dhe joproporcional, duke krijuar efekt përjashtues ndaj operatorëve ekonomikë. Kërkesa për mostër bie në kundërshtim me nenin 69, 2.4 dhe nenin 7 të LPP-së, pasi nuk është as relevante, as e nevojshme dhe është teknikisht e pamundur për t'u përmbushur brenda afatit të dhënë. Për më tepër, zgjatja e afatit nuk ka qenë 10 ditë pune, por vetëm 10 ditë kalendarike, çka nuk adreson ndikimin e ndryshimeve të bëra.

Mendimi i ekspertit teknik

Në dosjen e tenderit të korrigjuar nga AK më datë 24.11.2025, e cila është bërë publike në platformën e e-Prokurimit më datë 25.11.2025 dhe, për rrjedhojë, e qasshme për operatorët ekonomikë (OE) të interesuar në këtë procedurë, AK ka përcaktuar afatin e fundit për dorëzimin e ofertave më datë 04.12.2025. Po ashtu, në këtë dosje të korrigjuar është shtuar kërkesa që dorëzimi i mostrave të jetë obligativ për Llot I dhe Llot II, të cilat duhet të dorëzohen në objektin e MASHT më datë 04.12.2025, deri në ora 12:00.

Kjo kërkesë nuk ishte e përcaktuar as në njoftimin për kontratë dhe as në dosjen fillestare të tenderit, të publikuar nga AK më datë 05.05.2025. Eksperti, fillimisht, sqaron se kërkimi i mostrave për produkte të TI-së nuk paraqet praktikë të zakonshme në fushën e prokurimit publik, përfshirë edhe praktikat e vetë AK-së në aktivitetet e mëparshme të prokurimit për produkte të njëjta ose të ngjashme, meqenëse vlerësimi i përmbushjes së kërkesave teknike zakonisht bëhet në bazë të dokumentacionit teknik dhe broshurave zyrtare të prodhuesit për produktin e ofertuar.

Më tej, AK nuk e kishte përcaktuar kërkesën për dorëzimin e mostrave në njoftimin fillestar për kontratë dhe në dosjen fillestare të tenderit, duke e përfshirë këtë kërkesë vetëm në fazën e korrigjimit të dosjes së tenderit, pas marrjes së vendimit të OSHP-së. Një veprim i tillë përbën ndryshim thelbësor të kushteve të tenderit dhe ndikon drejtpërdrejt në përgatitjen dhe konkurrencën e ofertave të operatorëve ekonomikë, për faktin se pajisjet në fjalë nuk janë të zakonshme në treg dhe nuk mund të sigurohen brenda afatit dhjetë ditor të përcaktuar.

Si rrjedhojë, kërkesa e tillë në rrethanat e sqaruara mësipër bie në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë transparencën, trajtimin e barabartë dhe konkurrencën, si dhe me kriteret e përzgjedhjes. Andaj, pretendimi ankimor vlerësohet si i bazuar dhe Eksperti i rekomandon Panelit Shqyrtues që ta obligojë AK-në të largojë kërkesën për dorëzimin e mostrave nga dosja e tenderit.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet e bazuar, të bëhet korrigjimi i dosjes së tenderit dhe të zgjatet afati për dorëzimin e tenderëve, në përputhje me nenin 53 të Ligjit për Prokurimin Publik.

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E ARSIMIT**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **ARITECH**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT PRISHTINË/A TELOZA RAZMATRANJE NABAVKI REPUBLIKA KOSOVA

**Majlinda Bedrolli**

**Kreshnik Spahiu**